



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 13 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, nenit 12 të Rregullorës për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, si dhe Vendimit për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit, 15Nr.400-71876 të datës 27.11.2018, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS PËR SHËRBIMET E VARRIMIT PËR KËRKESAT E
MUAJIT QERSHOR 2020**

- I. OBLIGOHET, Drejtorati për Buxhet dhe Financa të bëjë ekzekutimin e pagesës në shumë prej 4,590.00 € (katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë euro) për shërbimet e varrimit për 27 (njëzet e shtatë) kërkesat e parashtruara në muajin qershor 2020, me nga 170 € për secilin rast konform Vendimeve të tyre individuale për ndarjen e mjeteve financiare
- II. Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogaritë bankare personale të parashtruesve (familjarëve) të kërkesave.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është lista me të dhënat e parashtruesve të kërkesave në formë tabelare për muajin qershor 2020.
- IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400-27937
Lipjan, më 08.07.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

